



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Nr. i Dokumentit: 21.6.7-2017-08

RAPORT I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR PËR PROJEKTIN
"PROGRAMI MJEDISOR I KOSOVËS - PMK 2016-2020"
PËR PERIUDHËN 01.11.2016 deri më 31.12.2017

Auditim në bazë të marrëveshjes me SIDA-në

Prishtinë, prill 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Raportin Vjetor Financiar për Projektin “Programi mjedisor i Kosovës - PMK 2016-2020”, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Blerina Krasniqi (udhëheqëse ekipi) dhe Fatlinda Podvorica (anëtare), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Astrit Bllaca.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	8
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	10
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	13

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor për projektin “Programi mjedisor i Kosovës – PMK 2016-2020” për periudhën 01.11.2016 deri më 31.12.2017, (më tutje periudha audituese) i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i raportit financiar për periudhën audituese është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me raportin financiar.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për periudhën audituese është përcaktuar varësisht nga shpenzimet e ndodhura për këtë periudhë.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Raporti Vjetor Financiar *paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017

Sekretari i Përgjithshëm është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e raportit financiar dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat, sistemet dhe transaksionet financiare janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në zbatim;
- Nëse raporti financiar është në pajtim me kërkesat e marrëveshjes së veçantë ndërmjet Qeverisë së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Suedisë, përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, SIDA (Suedia);
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Metodologjia e auditimit është fokusuar në ekzaminimin e të dhënave dhe transaksioneve financiare, përfshirë dokumentacionin mbështetës. Ne kemi përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit.

Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i raportit financiar vjetor merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në raportin financiar. Po ashtu ne kemi konsideruar edhe krahasimin e realizimit të shpenzimeve në raport me planifikimin e aktiviteteve të projektit.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar Raportin Financiar të projektit të financuar nga SIDA "Programi mjedisor i Kosovës - PMK 2016-2020", për periudhën 01.11.2016 deri më 31.12.2017, i cili përfshinë një përmbledhje të shpenzimeve për aktivitetet e realizuara në këtë periudhë.

Sipas opinionit tonë, Raporti Financiar për periudhën 01.11.2016 deri më 31.12.2017, prezanton një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme).

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është përgjegjëse për zbatimin e projektit dhe për menaxhimin e kontributeve financiare nga SIDA. Kontributi financiar i SIDA-së përbëhet nga dy pjesë: disbursimet drejtpërdrejt tek Qeveria (Thesar) si dhe pagesat drejtpërdrejt tek ofruesi i asistencës teknike për shpenzimet e shkaktuara. MMPH është përgjegjëse për mbajtjen e kontabilitetit si dhe për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të raportit financiar vjetor.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për raportin financiar në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se raporti financiar nuk përmban keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtij raporti financiar.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpалosjet në raportin financiar. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në raportin financiar, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e raportit financiar nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të raportit financiar.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportin dhe kërkesat tjera për raportim

MMPH kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat e marrëveshjes së veçantë ndërmjet Qeverisë së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Suedisë, përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, SIDA (Suedia).

Në kontekst të raportimit, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Në lidhje me fondet e shpenzuara nga MMPH-ja është përgatitur raporti përmbledhës, derisa ky raport më tej do të përfshihet në Pasqyrat Financiare Vjetore të "Konsoliduara" të MMPH-së. Raportimi financiar është bërë në përputhje me marrëveshjen, po ashtu janë përgatitur raporte narrative që përmbajnë një analizë mbi progresin e aktiviteteve të projektit dhe rezultatet.

3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Pjesa më e madhe e shpenzimeve i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime. Kjo është paraqitur në tabelen e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet e ndodhura dhe krahasimi me buxhetin (në €)

Përshkrimi	Buxheti 01.11.2016 - 31.12.2017	Realizimi 01.11.2016 - 31.12.2017	Buxheti i pashpenzuar
Shpenzime të udhëtimit zyrtar brenda vendit	52,348	0	52,348
Shpenzime të udhëtimit zyrtar jashtë vendit	27,208	0	27,208
Shërbime arsimit/trajnimi	10,551	0	10,551
Shërbime shtypi - jo marketing	5,277	0	5,277
Shërbime kontraktuese tjera	464,665	119,506	345,159
Kompjuter më pak se 1,000 €	9,496	0	9,496
Pajisje tjera më pak se 1,000 €	42,445	0	42,445
Vetura zyrtare	6,272	0	6,272
TOTALI	618,262	119,506	498,756

Çështja 1 - Realizimi i buxhetit

- E gjetura** Realizimi i buxhetit për periudhën 01.11.2016 deri më 31.12.2017 ishte në nivel të ulët, vetëm 19% e buxhetit ishte realizuar e kjo ishte rezultat i vonesave në fillimin e realizimit të projektit. Këto vonesa kanë rezultuar kryesisht për shkak të problemeve administrative, si, vonesa në përzgjedhjen e kompanisë implementuese të projektit, pastaj nevoja për amendamentimin e marrëveshjes bazë, e të ngjashme.
- Rreziku** Realizimi i ulët i buxhetit e redukton efektivitetin e planit vjetor operativ dhe vështirëson arritjen e objektivave të synuara të projektit.
- Rekomandimi 1** Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me implementuesin e projektit duhet të ndërmarr një vlerësim të arsyeve për nivelin e ulët të realizimit të buxhetit si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e realizimit të tij në periudhën e ardhshme të projektit.

3.1 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për periudhën raportuese për këto kategori ishte 618,261€, prej tyre ishin shpenzuar 119,506. Kontrollat në fushën e shpenzimeve kanë funksionuar mirë, megjithatë nevojiten veprime shtesë për adresimin e mangësive në vijim.

Çështja 2 – Menaxhimi i shpenzimeve të prokurimit

E gjetura Rregulla e thesarit nr. 01/2013 kërkon që regjistrimi në SIMFK duhet të bëhet konform kodeve të planit kontabël në kodet për avanset në mallra, mandej përgjatë gjithë vitit duhet të bëhen arsyetimet varësisht prej trendëve të realizimit të projektit.

MMPH kishte nënshkruar marrëveshje të mirëkuptimit për prokurimin e shërbimeve në vlerë 6,618,765 krona me kompaninë suedeze e cila kishte kontratë me SIDA-n për implementimin e projektit 'Programi mjedisor i Kosovës - PMK 2016-2020'. Marrëveshja parasheh që MMPH në fillim të projektit do të paguaj një avans në vlerë 900,000 krona suedeze (apo 94,906€), i cili do të mbetet i hapur përgjatë gjithë kohës së projektit. Pagesa e avansit nuk ishte bërë nga kodi për avanse, por nga kodi shërbime kontraktuese tjera (13460).

Edhe pse në raportin përfundimtar të projektit, janë paraqitur shpenzimet për aktivitetet e realizuara në përputhje me linjat e parapara buxhetore, dokumentet financiare mbështetëse për to nuk janë prezantuar dhe arsyetuar në MMPH.

Më tej, marrëveshja parasheh që MMPH do të paguaj një tarifë për menaxhimin e prokurimit kompanisë implementuese në vlerë 3% të buxhetit të prokuruar, përderisa kjo tarifë nuk është e paraparë apo e bazuar në marrëveshjen bazë ndërmjet SIDA-së dhe MMPH.

Rreziku Nënshkrimi i marrëveshjeve ku parashihen avanse fikse, apo të hapura për më shumë se një vit, dhe pagesa e tyre nga kodi jo adekuat është në kundërshtim me rregullat dhe rezulton në mos arsyetim me kohë të avansit dhe rrjedhimisht edhe prezantim jo të drejtë të shpenzimeve të ndodhura. Pagesa e tarifave të pabazuara dhe të cilat nuk janë paraparë me marrëveshje nga ana e ministrisë mund të rezulton me pagesa te parregullta.

Rekomandimi 2 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se të gjitha marrëveshjet e Ministrisë bëhen në përputhje me rregullat e thesarit për shpenzimin e parasë publike, ku avanset regjistrohen në kodet përkatëse dhe të njëjtat në fund të vitit arsyetohen me dokumente mbështetëse, në mënyrë që të sigurohet prezantimi i drejtë i shpenzimeve. Po ashtu, pagesat e tarifave të menaxhimit për kompanitë e kontraktuara për kryerjen e shërbimeve në emër të projektit, duhet të jenë të bazuara në marrëveshjet përkatëse.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinionin të kualifikuar, opinionin të kundërt dhe mohimin të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATA E SHKRESE (DATE)			24.04.2018
Numeri Org. (Org. No.)	Skajti Kod (Class. Code)	No. Prot. (Prot. No.)	No. Pajtim. (No. Pajtim.)
03	401	561	1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për periudhën 01.11.2016 deri më 31.12.2017 dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë, 23/04/2018

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Raportit Financiar të projektit të financuar nga SIDA "Programi mjedisor i Kosovës – PMK 2016-2020", për periudhën 01.11.2016 deri më 31.12.2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Sekretari i Përgjithshëm:

Arben Çitaku

